

## **THIRRJE PËR APLIKIM: EKSPERT PËR HARTIMIN E VLERËSIMIT TË SITUATËS SË FËMIJËVE SHQIPTARË QË SHFRYTËZOHEN PËR PUNË NË VENDET FQINJË**

**Shoqata:** Caritas Shqiptar

**Titulli Projektit:** “Fuqizimi i strukturave shtetërore në mbrojtje të fëmijëve Shqiptarë që shfrytëzohen për punë në vendet fqinjë”

**Afati për aplikim:** 7 shkurt 2018

**Lloji i punës:** Ekspert

**Kohëzgjatja e detyrës:** 15 Shkurt – 15 Mars 2018

### **Hyrje**

Caritas Shqiptar është një shoqatë humanitare që punon për përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve më të varfër dhe më në nevojë në Shqipëri. U themelua në vitin 1993 nga Konferenca Ipeshkvnore e Kishës Katolike dhe u njoh nga shteti Shqiptar si një organizatë bamirëse e Kishës Katolike Shqiptare. Që nga viti 1994, Caritas-i Shqiptar është anëtar i Caritas Internacionalis dhe Caritas Europa, rrjeti botëror i organizatave Katolike që ofrojnë ndihmë për grupet në nevojë.

Gjatë 23 viteve të fundit Caritas Shqiptar ka zbatuar projekte mbi anti trafikimin, mbrojtjen e fëmijëve dhe grave në situatë rreziku, fuqizimin e strukturave që punojnë me çështje të mbrojtjes së grupeve në nevojë financuar nga Qeveria Amerikanë, Angleze, Franceze, Caritas Amerikan, Caritas France, UNHCR etj.

Caritas Shqiptar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Anti Trafik dhe financimin e Qeverisë Franceze dhe CRS do të zbatojnë një projekt një vjeçar me titull “Fuqizimi i strukturave shtetërore në mbrojtje të fëmijëve Shqiptarë që shfrytëzohen për punë në vendet fqinjë” me qëllim përmirësimin e identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së fëmijëve shqiptarë të shfrytëzuar për punë në Mal të Zi dhe Kosovë.

Caritas Shqiptar kërkon të punësojë një ekspert/e për të hartuar një vlerësim cilësor dhe sasior mbi situatën e fëmijëve që shfrytëzohen për punë në vendet fqinje, bazuar dhe në indikatorët e paraqitur në planin e veprimit të projektit. Eksperti do të përgatisë një raport ku të analizojë të dhënat e mbledhura dhe ofrojë rekomandime për përmirësimin e situatës.

### **Përshkrim i Projektit**

Projekti “Fuqizimi i strukturave shtetërore në mbrojtje të fëmijëve Shqiptarë që shfrytëzohen për punë në vendet fqinjë” është në një linjë me “*Protokollet shitesë për intensifikimin e veprimeve për identifikimin, referimin*

e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, veçanërisht fëmijët”, të nënshkuara nga Koordinatorët Kombëtarë të Kosovës (2012) dhe Malit të Zi (2014) si dhe me procedurat e unifikuara në dhjetor 2016. Caritas Shqiptar do të organizojë disa tryeza diskutimi midis palëve Shqipëri – Kosovë dhe Shqipëri - Mal i Zi, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga policia e kufirit dhe institucionet lokale që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Këto tryeza do të shërbejnë për të analizuar hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Këto tryeza do të shërbejnë për të identifikuar problemet ekzistuese në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve që shfrytëzohen për punë në vendet fqinje, ofrojnë rekomandime për përmirësimin e situatës si dhe përgatisin një plan veprimi të përbashkët për parandalimin e fenomenit dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar në sistemin e mbrojtjes.

Projekti do të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve kyç të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal dhe do të rrisë kapacitetet e personelit ligjzbatues në identifikimin dhe referimin e fëmijëve shqiptarë që shfrytëzohen për punë në vendet fqinje.

### **Shtrirja gjeografike e detyrës**

Vlerësimi i situatës do të kryhet në Kukës dhe Shkodër. Megjithatë eksperti/ekspertja do të kryejë intervista edhe me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse qendrorë.

### **Qëllimi i vlerësimit të situatës**

Vlerësimi do të shërbejë për promovimin e ndërhyrjeve të bazuara në evidenca.

1. Përcaktojë konkretisht etapat e ndërhyrjeve bazuar në situatën aktuale në vendet ku do të zbatohet projekti.
2. Ofrojë rekomandime për të realizuar objektivat e projektit.

Vlerësimi duhet të përmbajë

1. Një analizë të përgjithshme cilësore dhe sasiore të kapaciteteve dhe njohurive institucionale në nivel lokal mbi situatën e fëmijëve shqiptarë që shfrytëzohen për punë në Mal të Zi dhe Kosovë;
2. Një vlerësim të koordinimit të mekanizmave lokal në identifikimin dhe referimin e rasteve;
3. Masat e marra për parandalimin e situatës;
3. Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit të mekanizmave lokal;
4. Rekomandime për përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive institucionale në zbatimin e roleve dhe përgjegjësi.

### **Metodologjia e vlerësimit**

Metodologjia e vlerësimit duhet të bazohet në parimin e pjesëmarrjes. Eksperti/ekspertja do të bashkëpunojë me stafin e projektit për të hartuar metodologjinë dhe analizuar të dhënat.

Eksperti do të realizojë studimin në komunitetet e përcaktuara për një periudhë një mujore 15 Shkurt – 15 Mars 2018. Metodologjia e studimit do të orientohet drejt mbledhjes së të dhënave cilësore dhe sasiore në Shkodër dhe Kukës.

### **Informacione të tjera**

Vlerësimi do të kryhet në zonat e përcaktuara me pjesëmarrjen e institucioneve të ndryshme lokale si Policia e Kufirit dhe Migracionit, Shërbimi Social, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, etj. Të dhënat e mbledhura do të ndahen sipas gjinisë, institucionit dhe pozicionit. Caritas Shqiptar do të ndihmojë për të koordinuar zbatimin e vlerësimit me institucionet lokale dhe mund të shoqërojë ekspertin sipas nevojës.

### **Çfarë duhet dorëzuar nga eksperti në fund të detyrës**

- Instrumentet për vlerësimin cilësor dhe sasiore;
- Metodologjinë dhe periudhën kohore të zbatimit të aktiviteteve për realizimin e vlerësimit;
- Raport me të dhëna sasiore për vlerësimin në Excel, Access apo SPSS;
- Vlerësimin duke përfshirë përfundime dhe rekomandime (për vlerësime të mëtejshme dhe monitorimin e arritjes së indikatorëve të projektit).

**Shënim:** Çdo dokument duhet dorëzuar në gjuhën angleze

Dokumentet përfundimtare do të vlerësohen dhe miratohen nga strukturat përgjegjëse në Caritas Shqiptar. Një draft vlerësim në gjuhën angleze do të dërgohet paraprakisht për komente para finalizimit të vlerësimit.

### **Përgjegjësitë e ekspertit/es**

Personi i përzgjedhur do jetë përgjegjës për lehtësimin e të gjitha fazave të hartimit të vlerësimit, përgatitjen e metodologjisë pjesmarrëse, zbatimin, analizimin dhe raportin përfundimtar.

Disa nga përgjegjësitë përfshijnë:

- Hartimi i një plan veprimi, duke përfshirë dhe kalendarin e aktiviteteve
- Hartimin e një metodologjie cilësore dhe sasiore për vlerësimin
- Instrumentet për mbledhjen e të dhënave
- Pyetësorët për intervista me aktorë kyç
- Analizimin e të dhënave të mbledhura
- Hartimin i raportit përfundimtar

Të gjithë aktivitetet duhet të koordinohen me Caritas Shqiptar (si pyetësorët, mbledhja e të dhënave, rekomandimet etj.)

Eksperti/ekspertja do të koordinohet dhe mbajë kontakte me Projekt Menaxherin në Caritas Shqiptar. Projekt menaxheri është përgjegjës për dhënien e të dhënave të kërkuara nga eksperti dhe koordinimin e aktiviteteve për mbledhjen e të dhënave në terren.

Eksperti dhe Projekt Menaxheri do të koordinohen për përcaktimin e afatave kohore për dorëzimin e dokumentave të nevojitur.

### **Kriteret për aplikantët**

- Diplomë Universitare në shkencë sociale (Master apo PhD do të ishte një vlerë e shtuar);
- Së paku 3 vjet përvojë në fushën e hartimit të vlerësimeve, studimeve etj.;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze;
- Njohuri mbi situatën e shfrytëzimit të fëmijëve për punë në Shqipëri;
- Aftësi shumë të mira analitike dhe krijuese;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe për të hartuar koncepte shumë qartë dhe saktë në shkrim dhe me gojë;

### **Oferta financiare**

Eksperti duhet të ketë parasysh ditët e punës së nevojitura për kryerjen e vlerësimit, koston e transportit dhe të gjitha shpenzimet e tjera të lidhura me vlerësimin duke u shoqëruar me një plan zbatimi të detajuar. Kostot e udhëtimit mund të përcaktohen sipas tabelës bashkëngjitur:

<b>Qarku</b>	<b>Distanca nga Tirana</b>
Kukës	137 km
Shkodër	94 km

### **Dokumentacioni i nevojitur për aplikim**

- CV e personit/personave që aplikojnë
- 2 kontakte referencash
- Modele punimesh të ngjashme
- Një kërkesë jo më shumë se 3 faqe ku të paraqesni strukturën e vlerësimit, metodologjinë dhe kalendarin e mbledhjes së të dhënave
- Buxheti

### **Afati për aplikim**

Dokumentat e nevojitura duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme brenda datës **7 shkurt 2018, ora 16:00**.

**Adresa:** Rruga Don Bosko; Nr. 4 Tiranë; Tel: + 355 4 22 30088; Fax: + 355 4 22 34327